REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA NAZIRANJE NABAVKI

Nr/Br. 456/20
Datë/Datum. 08.07.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: Këshillit Prokurorial të Kosovës

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: *250-20-2760-1-2-1*

Sa i përket tenderit për *Furnizim me pajisje të TI-së për nevoja të Sistemit Prokurorial të Kosovës*

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Botek shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr. Agim Ramadani, objekti C, nr 517
(Adresa)

Prishtinë — *10000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*

038-245-830/840 — *038-245-625*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Hilmi Asllani
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
info@bo-tek.com
(Adresa elektronike)

08.07.2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

IT Communication · Energy
BOTEK sh.p.k.
2003 Prishtinë, Republika e Kosovës 2015

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- *B05 Njoftimi për kontratë, datë 12.06.2020.*
- *B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, datë 01.07.2020.*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ **Jo** ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Me datë 06.07.2020 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- *Neni 5 i LPP, pika2*
- *Neni 7 i LPP, pika 1 dhe 2*
- *Neni 28 i LPP, pika 2, 3 7 dhe 8*
- *Neni 108/A i LPP.*

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ankesa jonë pranë OSHP vjen si rrjedhojë e refuzimit nga AK që Kërkesa jonë për Rishqyrtim të trajtohet (Prova 1_**Kërkesa për Rishqyrtim** dhe Prova 2_***"Vendimi nga AK mbi refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim").*** Refuzimi është bërë me arsyetimi *"Kërkesa është paraqitur jashtë afateve të rregullta ligjore"*. Ky arsyetim si i tillë dhe vendim është i pabazuar pasi që ne Kërkesën për Rishqyrtim e kemi deponuar brenda afatit prej 5 ditëve, para datës së fundit për dorëzim të ofertave, ashtu sikurse e parasheh edhe neni 108/A i LPP.

Për ta konfirmuar këtë në vazhdim po e shpjegojmë në formë kronologjike:

Me datën **29.06.2020**, kemi pranuar përgjigjet në kërkesën tonë tonë për Sqarime Shtesë (Prova 3_**Pergjigjet e AK ne sqarimet shtese_kerkesa nga Botek**), përderisa afati për dorëzimin e ofertave, sipas dosjes se tenderit, fillimisht ka qenë data **01.07.2020**

Pas pranimit të përgjigjeve nga AK, të cilat ne konsiderojmë se përbëjnë shkelje të nenit 7 dhe 28, dhe në pamundësi kohore për të parashtruar Kërkesën për Rishqyrtim brenda afateve ligjore, ne kemi dërguar ***"Kërkesë për shtyrje të afatit "*** (Prova 4), tek AK për shtyrje te afatit për dorëzimin e tenderit edhe për së paku 10 ditë ashtu sikurse parashihet edhe me LPP.
AK duke marrë për bazë kërkesën tonë por edhe LPP ka marrë vendim për shtyrjen e afatit për dorëzimin e ofertave me datë 30.06.2020, ***"Njoftimi per shtyrjen e afatit të dorëzimit të ofertave"*** (Prova 5), duke përcaktua datën **10.07.2020** afatin e fundit për dorëzim të ofertave.
Pasi që dita e fundit e afatit 5 ditor (para hapjes së tenderit) për dorëzim të Kërkesave për Rishqyrtim ka qenë e Diel (05.07.2020), ne kemi dorëzuam Kërkesen për Rishqyrtim në

atë në ditën e parë të punës, ditën e hënë datë 06.07.2020, sikurse e parasheh LPP dhe UOPP, dhe "arsyetimi i AK nuk qëndron.

LPP Neni 5, pika 2

"Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj".

Ligji Nr. 05/L -031 PËR PROCEDURËN E PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

Neni 81, pika 4 : *Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk do të pengojnë fillimin dhe ecjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie të shtunën, të dielën apo një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen menjëherë pas saj.*

Në vijim po i drejtojmë pyetjet dhe kërkesat të cilat i kemi përgatitur në Kërkesën për Rishqyrtim të cilat i kemi adresuar tek AK.

Duke marrë për bazë përgjigjet e AK në kërkesat e OE për sqarime shtesë, fatkeqësisht vijmë shpejt dhe me prova në konstatimin se AK ka shkelur LPP, konkretisht Nenin 7 *"Barazia në Trajtim/Jo-diskrimimin"* pika 1,2.

Pika 1 "Autoriteti kontraktues do t'i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente".

Pika 2 "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose më shumë operatorëve ekonomik"

Si dhe Neni 28 *"Specifikimet Teknike"* pika 2, 3, 7, 8 dhe UOPP.

Pika 2 "Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik".

Pika 3 "Specifikimet teknike do të formulohen ose duke iu referuar standardit të aplikueshëm, specifikimit, miratimit apo referencës teknike që kërkohet sipas paragrafit 4 dhe 5 të këtij neni ose si një alternative lidhur me kërkesat e ekzekutuese ose funksionale, duke përfshirë karakteristikat mjedisore sipas paragrafit 9. të këtij neni. Autoriteti kontraktues mund të zgjedhë që të përdorë standardet ose specifikimet tjera sipas paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni për karakteristika të caktuara dhe kërkesat e ekzekutuese ose funksionale për karakteristika tjera".

Pika 7 "Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të

lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent".

Pika 8 "Kërkesat ekzekutuese dhe funksionale duhet të jenë të sakta në mënyrë që të iu mundësoj tenderuesve që të përcaktojnë lëndën kryesore të kontratës dhe t'i lejoj autoritetet kontraktuese që të shpërblejnë kontratën. Standardet apo specifikimet e tjera të paragrafit 4. dhe 5. të këtij neni mund të përdoren si një mjet i ruajtjes së përputhshmërisë me kërkesat ekzekutuese apo funksionale".

Në vijim po i shtrojmë në detaje disa nga to:

Një OE ka pyetur: Keni kërkuar tek Height adjustable sëivel pivot tilt monitor stand: Tilt: -5 to +30°; Height: 100 mm, Elevation- Ju lutem na sqaroni a mund të ofertojmë monitor Tilt- 5° to +23, Sëivel 360°, Pivot Clockëise 90°, Height Adjustment Range 100 mm.

Përgjigja e AK ka qenë: *"Në dosjen e tenderit është cekur që të prezantohet specifika teknike minimale, me ç'rast nënkupton se specifikt teknike duhet të jen ato të prezantuara apo edhe më të avancuara por asesi nën specifikat minimale të prezentuara".*

- **Konstatimi jonë dhe kërkesa:** Devijime të tilla të vogla/minore lejohen me LPP dhe praktikat e prokurimit dhe në shumë vendime të OSHP mund të konstatoni se janë të pranueshme devijime minore. Në rastin konkret, për faktin se: Specifikim teknik në këtë pikë e keni kopjuar nga një model i caktuar i prodhuesit HP dhe rrjedhimisht mund ta përmbush ai prodhues, por prodhues të tjerë prodhojnë Monitor me parametrin TILT paksa më ndryshe, si psh: Tilt -5° to +21° dhe se AK nuk ka asnjë bazë ligjore, por edhe asnjë arsye praktike dhe profesionale për te refuzuar devijime të tilla, e sidomos kur monitori ka performancë më të avancuar në disa parametra tjerë!

Pyetje nga një OE: Keni kërkuar Procesori: 8 MB Cache, 4 Cores, 8 Threads, up to 3.5 GHz Max Turbo Frequency- Ju lutem na sqaroni sepse keni kërkuar 8 MB Cache, 4 Cores, 8 Threads, 3.5 GhZ procesor i cili nuk ekziston.

Përgjigja nga AK ka qënë: *"Ekziston një numër i madh i procesorëve që janë në përputhje me këtë specifik teknike andaj në dosjen e tenderit është cekur që prezantohet specifika teknike minimale, me ç'rast nënkupton se specifikat teknike duhet të jenë ato të prezantuara apo edhe më të avancuara, por asesi nën specifikat minimale të prezantuar".*

- **Konstatimi jonë dhe kërkesa:** Kjo lloj përgjigje jo vetëm se nuk është profesionale, por ka dyshime të bazuara se kemi të bëjmë me përgjigje qëllimisht të paqarta, konfuze dhe tendencioze.

  Ky lloj procesori dhe shumë parametra tjerë të specifikimeve teknike, janë marrë "copy-paste" nga një modeli i vjetër (mbi 3 vite) nga prodhuesi HP dhe ashtu sikurse ju kemi shkruar edhe ne pyetjet tona për sqarime shtesë, kemi dyshimë të bazuara se AK po vepron në interesin e një OE të caktuar, i cili ka në stoqet e tij PC të përdorura (refurbished) dhe se krejt tendenca është që AK të favorizoj këtë OE dhe në fund të blejë pajisje të përdorura.

  Prandaj pyetja ka qenë: A lejohet vërtet të ofertohet me pajisje më të vjetra se 2 vite, pra me pajisje të përdorura apo NUK është e lejuar të ofertohet me pajisje më të vjetra se viti 2019?

Pyetja jonë për sqarime shtesë ka qenë: **Referenca 1**_Artikulli - 1. Desktop PC – I- Brand Name dhe Artikulli - 2. Laptop – II- Brand Name "*Sistem Operativ: Windows 10 Pro, Përkrahje: Windows 7, 8, 10"*

SQARIM: Përkrahja e kërkuar për Windows 7, si e tillë është e parealizueshme dhe NUK ka mundësi të ofertohet nga asnjë prodhues botërorë serioz me pajisje të gjeneratës të fundit 2019/2020.

Pra, kjo përkrahje praktikisht mund të realizohet vetëm me PC/Laptop të modeleve me të vjetra (2016/2017/2018) - Refurbished, por kurrsesi me PC të modeleve të reja të vitit 2019 apo 2020.

Për më tepër ju mund të gjeni qëndrimin zyrtarë të prodhuesve në lidhje me mundësin e përkrahjes gjegjësisht ndërprerjes së përkrahjes nga Microsoft për Windows 7.

Support for Windows 7 ended on January 14, 2020.

https://www.microsoft.com/en-us/microsoft-365/windows/end-of-windows-7-support

KËRKESË: Rrjedhimisht kërkojmë që kjo kërkesë (e dyshimtë dhe se qëllimisht e vendosur) duhet të eliminohet apo të lejohet që të ofertohet me Pajisje të gjeneratës së fundit 2020 me SO Windows 10, të cilët NUK përkrahin më Windows 7 apo 8. pasi që NUK ka as edhe një arsye të vetme logjike dhe praktike.

Pra, për të përjashtuar mundësin e manipulimit dhe liferimin e pajisjeve me të vjetra se 2 vite – Refurbished ju si AK duhet të qartësoni sakt se NUK lejohet të liferohen pajisje me të vjetra se 2 vite apo Refurbished.

Përgjigja nga AK Referenca 1: *Duke pas parasysh se është kërkuar furnizim me pajisje fizike (Harduer) dhe të ketë të instaluar OS Windows 10 Pro, i cili ka përkrahje dhe është aktual në përdorim, por këto pajisje harduerike duhet te përkrahin edhe sistemet e tjera operative siç janë kërkuar në specifikat teknike dhe asesi nuk është kërkuar support për këto sisteme.*

- **Konstatimi jonë dhe kërkesa:** Kjo përgjigje tregon qartë tendencën e AK se gjithçka janë duke bërë dhe duke u ikur përgjigjeve për ta "justifikuar nesër gjatë vlerësimit të ofertave" se SO Windows 10 në pajisjet e reja të prodhuesve HP, DELL etj NUK e suporton/përkrahë Windows 7.

  Kjo për faktin se nuk ka kuptim logjik dhe funksional që në pajisjet e reja ku janë të instaluara Windows 10 Professional të përkrahë/suportojnë edhe Windows 7!!
  Ju lutem "perkrahja" dhe "supporti" nënkuptohet pothuajse e njëjta gjë?
  Pra, me këtë përgjigje si kjo e AK po tentohet të lihet si mundësi ofertimi i OE të caktuar me pajisje të përdorura/refurbished dhe më të vjetra se 3 vjet. Sepse vetëm gjeneratat më të vjetra se 3 vite e të cilat NUK ka mundësi të blihen të reja dhe specifikisht Procesori i kërkuar kanë qenë të instaluar ne PC të HP dhe përkrahin ende (neper broshura) por jo praktikisht Ëindos 7.

Pyetje 2. ***Referenca 2*** ***Artikulli - 1. Desktop PC- I- Brand Name "Case - power supply standard 24 pin."***

SQARIM: Përkrahja e kërkuar për power supply standard 2-1 pin eliminon pothuajse te gjithë prodhuesit e PC brand name pasi që ky lloj Power Supply përdoret për Custom PC (PC të kompletuar vetë) dhe Jo per brand name. Prodhuesit Brand Name në PC përdorin power supply të ndryshëm bazuar ne modele të ndryshme të PC dhe të cilët Jo domosdoshmërisht Janë 24pin, mirëpo të njëjtit nuk kanë ndonjë mangësi nga standard 24 pin PSU.

KËRKESE: Rrjedhimisht kërkojmë që kjo kërkesë (e dyshimtë dhe se qëllimisht e vendosur), duhet të eliminohet apo të lejohet që të ofertohet me Pajisje të gjeneratës së fundit brand name, të cilët kanë Power supply të cilët janë të dizajnuar nga vetë prodhuesi.

Përgjigje Referenca 2: *Power Supply 24 pin është standard jo vetëm për costum PC por për të gjithë prodhuesit.*

- **Konstatimi jonë dhe kërkesa:** Kjo përgjigje e dhënë nga AK është e pabazuar teknikisht dhe në kundërshtim me LPP. Prodhuesit e PC-ve brand name si psh. Dell apo Lenovo nuk përdorin PowerSupply me 24pin ne Business PC-te e tyre.

Pyetje 3. Referenca 3 Artlkulll - 1.1 Monitor - I - Brand Name "Height adjustable swivel pivot tilt monitor stand Tilt: -5 to +30°; Height: 100 mm, Elevation

SQARIM: Përkrahja e kërkuar për Tilt: -5 to + 30°; eliminon pothuajse shumicën e prodhuesve të monitor brand name pasi qe Jo të gjithë monitorët kane shkalle të njëjtë të Tilt. Përveç tjerash lëvizja për +20 shkalle apo + 30 shkalle nuk ka ndonjë rol gjate punës ne zyre.

KËRKESË: *Rrjedhimisht kërkojmë që kjo kërkesë të eliminohet apo të lejohet që të ofertohet me monitor të gjeneratës së fundit brand name të cilët kane Tilt: -5 to + 20°*

Përgjigje nga ju si AK 3 : *Kërkesa është në përputhje me standardet ergonomike dhe praktike për përshtatshmërinë e këndit të pamjes së ekranit.*

- **Konstatimi jonë dhe kërkesa:** Kjo përgjigje e dhënë nga AK është e pabazuar dhe pa- justifikuar teknikisht si dhe në kundërshtim me LPP. Një devijim minor i këtij parametri është absolutisht e pavërejtshëm dhe praktikisht irelevant.

  Pra, edhe përmes kësaj përgjigje, ka sërish një tendencë të qartë që të favorizohet një Model i vjetër i një prodhuesi të caktuar (HP) dhe të eliminohen të gjithë prodhuesit tjerë nga gara. NUK mund të pretendoni ju se Prodhuesi DELL dhe prodhuesit të tjerë Brand Name me modelet e reja 2019 /2020 po prodhuakan Monitor me parametra jo mjaftueshëm ergonomikë se sa ky lloj i Monitori që AK ka specifikuar, e i cili është prodhim me i vjetër ma shumë se 3 vite !

Pyetje 4. ***Referenca 4*** ***Artikulli - 2.*** Laptop - II- Brand Name "Memorie: 8 GB, up to 64 GB"

SQARIM: Përkrahja e kërkuar për up to 64 GB eliminohet pothuajse shumicën e prodhuesve të laptop brand name si dhe e rrit koston e laptopit kur dihet se kërkesa është vetëm për 8GB RAM/ të instaluara.

KERKESE: Rrjedhimisht kërkojmë që kjo kërkesë të eliminohet apo të lejohet që të ofertohet me laptop me memorie up to 16GB, 24GB apo edhe 32GB.

Përgjigje 4. *Kërkesa në dosjen e tenderit nuk përjashton asnjë nga prodhuesit e njohur, duke parë zhvillimet e mëdha në teknologji tashme kapacitet memoruese nuk paraqesin ndonjë problem e sidomos tek brendet e njohura.*

- **Konstatimi jonë dhe kërkesa:** Kjo përgjigje e dhënë nga AK është e pabazuar dhe justifikuar teknikisht dhe në kundërshtim me LPP. Këmbëngulja e AK që Laptopi duhet të përkrah Memorie deri 64GB dhe se pse janë kërkuar vetëm 8 GB d.m.th. se AK planifikon të ua tetëfishon memorien e Laptopëve në vitet në 3-4 vitet në vijim?

  Kjo çka AK ka deklarua, ska kuptim, profesional, ekonomik, logjik dhe NUK mund të jetë e vërtet se do veprojnë kështu sepse;
  Së pari - NUK kishte me pas asnjë nevojë praktike ma shumë se dyfishimi apo trefishimi apo edhe katërfishimi i kapacitetit të memorieve.

E dyta - AK asnjëherë dhe ne asnjë rrethanë NUK i ka 8 X - fishua kapacitetet e memorieve në të kaluarën për asnjë lloj pajisje sepse NUK ka kuptim Logjik dhe praktik e as kuptim ekonomik.
Së treti - Po të kishit vërtet nevoja për kapacitete të tillë të RAM Memorieve, AK do kishte kuptim logjik dhe ekonomik ti kërkoni pajisjet p.sh. me 16 apo 32 GB, me ketë procedurë të prokurimit.

Bazuar në faktet që kemi paraqitur ne, kërkojmë nga Paneli Shqyrtues i OSHP, që të udhëzojë AK për ndryshimin e Specifikacioneve Teknike, duke marr parasysh edhe Kërkesën tonë për Rishqyrtim, në mënyrë që ky aktivitet i prokurimit të jetë i barabartë për të gjithë OE të interesuar.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne konsiderojmë se dëmet materiale janë humbja e kontratës me të cilin pësojmë në aspektin financiar,
Shpenzimet e përgaditjesë së Ankesës në OSHP.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *Kërkesa për Rishqyrtim, datë 06.07.2020 (prova 1)*
- *Vendimi nga AK mbi Kërkesën për Rishqyrtim, datë 07.07.2020 (prova 2)*
- *B05 Njoftimi për kontratë, datë 12.06.2020.*
- *Përgjigjet e AK në Sqarimet shtesë, datë 24 dhe 25.06.2020.*
- *Përgjigjet e AK në Sqarimet shtesë të bëra nga ne, datë 29.06.2020 (prova 3)*
- *Kërkesa për shtyerje të afatit për dorëzim të ofertave, datë 30.06.2020 (prova 4)*
- *Njoftimi për OE për shtyrje të afatit për dorëzim të ofertave, datë 30.06.2020 (prova 5)*
- *B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, datë 01.07.2020.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*